



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/83
Datë: 11.07.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 korrik 2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkriptit nga mbledhja e 78, 79, 80 dhe 81 e Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/83
Datë: 11.07.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 korrik 2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Strukturën Organizative të Njësive Profesionale për Zjarrfikje dhe Shpëtim.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/83
Datë: 11.07.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe 45 të Ligjit nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr.03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 korrik 2012, mori:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohen shpronësimet me interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga ndërtimi i Autostradës Vërmicë-Merdarë, Zona Kadastrale Arllat, Komuna Drenas, sipas tabelës të bashkangjitur këtij vendimi.
2. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH në mbështetje të Kuvendeve Komunale në territorin e të cilave gjenden zonat kadastrale, i dërgojnë vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelën e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është akti i vlerësimit dhe tabelat e bashkangjitura këtij vendimi në Aneksin 1. në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
5. Kundër këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar në këtë vendim, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka

një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkangjitura të këtij vendimi.

6. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është i detyruar të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
7. Vendimi hyn në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/83

Datë: 11.07.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 korrik 2012, mori:

V E N D I M

1. Zëvendësministri i Drejtësisë emërohet Koordinator Nacional Kundër Dhunës në Familje.
2. Koordinator ka përgjegjësinë për udhëheqjen e procesit të zbatimit të Programit të Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit për vitin 2011-2014, të miratuar nga Qeveria më 25 gusht 2011.
3. Koordinator udhëheq me Grupin Koordinues Ndër-Ministror Kundër Dhunës në Familje në këtë përbërje:
 - 3.1. Zyra e Kryeministrit-Agjencia për Barazi Gjinore zëvendës-kryesues;
 - 3.2. Ministria e Drejtësisë, anëtar;
 - 3.3. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, anëtar;
 - 3.4. Ministria e Punëve të Brendshme, anëtar;
 - 3.5. Ministria e Shëndetësisë, anëtar;
 - 3.6. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, anëtar;
 - 3.7. Ministria e Financave, anëtar;
 - 3.8. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve anëtar;
 - 3.9. Policia e Kosovës, anëtar;
 - 3.10. Agjencia e Statistikave të Kosovës, anëtar;
4. Në cilësinë e eksperteve dhe vëzhguesve ftohen:
 - 4.1. Prokuroria e Shtetit, anëtar;
 - 4.2. Këshilli Gjyqësor i Kosovës, anëtar;
 - 4.3. Instituti Gjyqësor i Kosovës, anëtar;

- 4.4. Koalicioni i Strehimoreve të Kosovës, anëtar.
5. Miratohen Termat e Referencës për Koordinator Nacional Kundër Dhunës në Familje dhe Grupin Koordinues Ndër-Ministror Kundër Dhunës në Familje, të cilat i janë bashkangjitur këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/83
Datë: 11.07.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 korrik 2012, mori:

V E N D I M

Për themelimin e Grupit Drejtues për Planifikim Strategjik

1. Themelohet Grupi Drejtues për Planifikim Strategjik në këtë përbërje:
 - 1.1. Dhurata Hoxha, Këshilltare Politike e Kryeministrit, Kryesuese;
 - 1.2. Ruzhdi Halili, Drejtori i Zyrës për Planifikim Strategjik, Zv. Kryesues
 - 1.3. Agim Krasniqi, Drejtori i Departamentit të Buxhetit, MF, anëtar;
 - 1.4. Eset Rama, Drejtori i Sekretariatit Koordinues të Qeverisë, anëtar;
 - 1.5. Besim Kajtazi, Drejtori i Zyrës Ligjore të ZKM-së, anëtar
 - 1.6. Florim Canolli Drejtor i Zyrës për Koordinimin e Asistencës së BE-së, MIE, anëtar;
 - 1.7. Valmira Rexhëbeqaj, Drejtore e Njesisë për Politika Makroekonomike, MF, anëtare;
 - 1.8. Bardha Rustemi, Ministria e Administratës Publike, anëtare.
2. Kryesuesi i Grupit Drejtues për Planifikim Strategjik në takime mund të ftojë të marrin pjesë edhe përfaqësues të institucioneve tjera dhe ekspertë.
3. Puna e Grupit Drejtues për Planifikim Strategjik mbështetet nga Zyra për Planifikim Strategjik.
4. Qëllimi i themelimit të Grupit Drejtues për Planifikim Strategjik është avancimi i strukturave institucionale përgjegjëse për koordinimin e zhvillimit të dokumenteve kryesore strategjike, sigurimi i harmonizimit të dokumenteve strategjike dhe ndërlidhjes me burimet buxhetore si dhe forcimi i koordinimit të proceseve kryesore planifikuese në Qeveri.

5. Grupi Drejtues për Planifikim të Strategjik në Qeverinë e Kosovës bën mbikëqyrjen e hartimit të dokumenteve kryesore strategjike dhe planifikimit strategjik në Qeverinë e Republikës së Kosovës.
6. Grupi Drejtues për Planifikim Strategjik është përgjegjës:
 - 6.1. Mbikëqyrë procesin e përcaktimit të prioritetëve të Qeverisë duke marrë parasysh edhe obligimet që dalin nga procesi i integritimit evropian;
 - 6.2. Siguron harmonizimin e buxhetit vjetor dhe planifikimit të burimeve tjera financiare me prioritetëve e Qeverisë të përcaktuara në deklaratën e prioritetëve;
 - 6.3. Mbikëqyrë procesin e hartimit të dokumenteve kryesore strategjike të Qeverisë Kosovës;
 - 6.4. Shqyrton dhe inicion zhvillimin e analizave të caktuara për çështje ndër-sektoriale të cilat i paraprijnë identifikimit të prioritetëve të Qeverisë;
 - 6.5. Kujdeset që dokumentet planifikuese dhe strategjike të zhvilluara nga ministritë të jenë në pajtim me politikat dhe prioritetet e Qeverisë, si dhe siguron konsistencën mes dokumenteve strategjike;
 - 6.6. Kujdeset për ndërlidhjen mes procesit të zhvillimit të politikave dhe planeve të punës me procesin e planifikimit buxhetor;
 - 6.7. Kujdeset që Plani i punës së Qeverisë, Plani i Veprimit për Partneritetin Evropian (PVPE) për Kosovën, Strategjia Legjislative, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve dhe dokumentet tjera strategjike e buxhetore janë të harmonizuara me njëra tjetrën;
 - 6.8. Siguron që aktivitetet kryesore planifikuese të Qeverisë të kryhen sipas kushteve dhe afateve të përcaktuar nga kalendari i planifikimit strategjik;
 - 6.9. Kujdeset që ndihma e jashtme të jetë e ndërlidhur dhe kontribuon në zbatimin e prioritetëve dhe planeve të Qeverisë dhe është e ndërlidhur me procesin e planifikimit buxhetor të Qeverisë;
 - 6.10. Kryen edhe detyra tjera që lidhen me procesin e planifikimit strategjik në Qeveri, sipas kërkesës.
7. Obligohet Zyra e Kryeministrit, Ministria e Financave dhe Ministria e Integritimit Evropian për zbatimin e këtij Vendimi.
8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/83
Datë: 11.07.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 korrik 2012, mori:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet vendimi i Qeverisë, Nr.04/81 i datës 27 qershor 2012 si në vijim: "Rreshti i fundit i pikës 2. të vendimit në vend të Ministrisë së Diasporës zëvendësohet me Ministrinë Infrastrukturës"
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/83
Datë: 11.07.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 8 të Ligjit Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.09/2011, si dhe duke pasur parasysh kontributin e profesor Ukshin Hotit për Lirinë dhe Pavarësinë e Kosovës si politikolog, idealist, filozof, vizionar i çështjes Kombëtare Shqiptare dhe si kolos i Pavarësisë së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 korrik 2012, mori:

V E N D I M

1. Universiteti i Prizrenit emërohet me emrin e Profesor Ukshin Hotit.
2. Obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/83
Datë: 11.07.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 korrik 2012, mori:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare shtesë në shumë prej 8,000.00 (tetë mijë) euro për rivarrosjen dhe ngritjen e lapidarit të heroit Hysen Tërpeza, në Viti.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Rezerva e Qeverisë dhe transferohen në Komunën e Vitisë, mjetet shfrytëzohen në pajtim me vendimin e Qeverisë nr.08/46 të datës 02.11.2011.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Komuna e Vitisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë